

**STATUT**  
**I**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**Bujtina “Allka” sh.p.k.**

Në Durrës, sot më datë 01.05.2025 (dymijë e njëzet e Pese), personi fizik:

**Z. Klodian Allka**, atësia Haki, amesia Lutfije, i lindur më 20.04.1980, në Gur, Lushnje dhe banues në Durres me adresë Rruga Aleksander Goga, Nd. 92, H 9, Ap. 7 shtetas Shqiptar, e identifikuar nëpërmjet leternjoftimit me Nr. I00420120C, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Mbështetur në Legjislacionin Shqiptar, kryesisht në ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008. “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, dhe të akteve të tjera ligjore në fuqi ka përpiluar dhe nënshkruar sot Statutin e Shoqërisë si më poshtë vijon:

**KAPITULLI I**  
**FORMA, EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA**

**Neni 1 – Forma**

- 1.1. Shoqëria **Bujtina “Allka” Sh.p.k.** (në vijim “Shoqëria”) eshte një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, veprimtaria e së cilës do të rregullohet me anë të këtij Statuti dhe nga legjislacioni në fuqi.
- 1.2. Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 1.3. Ky Statut është përpiluar në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe ka karakter të detyrueshëm pér nënshkruesit e tij. Çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në të, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.

**Neni 2 – Emërtimi dhe vula e shoqerise**

- 2.1. Emërtimi i Shoqërisë është **Bujtina “Allka” Sh.p.k.** Ajo do të ketë edhe vulën e saj.



### **Neni 3 – Objekti i shoqërisë**

Shoqëria **Bujtina “Allka” sh.p.k.** krijohet për të ushtruar aktivitetin e saj konform objektit që do të jetë: Bar Restoran, Bujtine.

Përveç veprimtarive të parashikuara më lart në veprimtarinë sipermarrese të shoqërisë do të hyjë çdo veprimtari tjeter industriale, tregtare, financiare dhe qe do të konsiderohet nga ortaku e nevojshme dhe e përshtatshme për arritjen e objektit të shoqërisë dhe që nuk ndalohet nga ligji.

### **Neni 4 – Selia**

- 4.1 Selia e shoqërisë do të jetë në adresën: Lushnje, Fshati Gur, Rruga e Divjakes, Numer pasurie 50/1 dhe Zone Kadastrale 1883
- 4.2. Transferimi i selisë së Shoqërisë në një vënd tjetër bëhet me vendimin e Asamblesë së Ortakëve.
- 4.3. Asambleja e Ortakëve vendos për hapjen e filialeve, adresave dytësore, degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë ose jashtë saj.
- 4.4. Asambleja e Ortakëve mund të ia delegoi këto kompetenca organit administrativ.

### **Neni 5 – Kohëzgjatja e veprimtarisë**

- 5.1. Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është e pakufizuar në kohë.
- 5.2 Shoqëria mund të prishet përpara këtij afati me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

## **KAPITULLI II**

### **KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE**

#### **Neni 6 – Kapitali themeltar**

Kapitali fillestar i shoqërisë është 100 000 lekë. Pjesemarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është 100 % i kapitalit të shoqërisë **Klodian Allka**.

Ortaku **Klodian Allka** është zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100 000 lekë, që përbën 100 % të kapitalit themeltarë të shoqërisë.

#### **Neni 7 – Kontributet/ Rritja e kapitalit themeltar**

Kontributi i përcaktuar në nenin 6 të këtij statuti i takon ortakut themelues në masën:

- a) Z. **Klodian Allka 100%**

*Klodian Allka*

*Reneff*

- 7.1 Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, një ose disa herë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 7.2. Rritja e kapitalit bëhet me vendimin të Asamblesë së Ortakëve, kur votohet pro me unanimitet të tërësisë së votave të Asamblesë së Ortakëve.
- 7.3. Vendim i vlefshëm merret vetëm nëse ortakët janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkressë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 te ligjit Nr. 9901 dt 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.
- 7.4. Zmadhimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakëve në proporcione pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre.

#### **Neni 8 – Zvogëlimi i kapitalit themeltar**

- 8.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar.
- 8.2. Zvogëlimi i kapitalit bëhet me vendim unanim të Asamblesë së Ortakëve.
- 8.3. Në çdo rast kapitali themeltar mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.
- 8.4. Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga ortaku në të njëjtën masë me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tij.

#### **Neni 9 – Transferimi i kuotave**

- 9.1 Transferimi i kuotave kushtëzohet nga e drejta e parablerjes në favor të ortakëve të tjera.
- 9.2. Në një rast të tillë, ortaku që do të transferojë kuoten/at e tij të kapitalit duhet t'i njoftojë ortakët e tjera.
- 9.3. Njoftimi bëhet me letër rekomande me kthim përgjigje dhe/ose me Letër Njoftimi nëpërmjet adreses elektronike (në vijim “Njoftimi”),
- 9.4. Në njoftim përcaktohen:
  - (a) numrin i kuotave të ofruara për shitje;
  - (b) emrin e blerësit/përfituesit të ofruar;
  - (c) çmimin e rënë dakord për çdo kuotë, i përcaktuar në çdo rast në para, ose në vlerën në para në rast të një kundërshpërblimi tjetër të mundshëm (në rast shkëmbimi, kompensimi vullnetar, transaksioni, dhe çdo rast tjetër transferimi me shpërblim), ose vlerën e objektit të transferimit në rastin e transferimit pa shpërblim;
  - (d) modalitetet e pagesës;
  - (e) ftesën për të ushtruar të drejtën e parablerjes.

Afatet dhe kushtet e mundshme për të cilat është rënë dakord midis transferuesit të kuotave dhe blerësit/përfituesit nuk do të jenë detyruese për ortakët e tjera të cilët do të ushtrojnë të drejtën e parablerjes.

E drejta e parablerjes i referohet të gjitha kuotave të kapitalit ofruar për shitje.

- 9.5. Ortakët do të kenë në dispozicion 3 (tre) muaj nga marrja e Njoftimit, për t'i komunikuar ortakut që transferon kuotat, synimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar, prezumohet se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.
- 9.6. Në rast se oferta pranohet nga disa ortakë, kuotat e ofruara nga ortaku që transferon kuotat, do të ndahen nga ortakët pranues, në të njëjtën masë me kuotat që ata zotërojnë, përvèç rastit kur ka një marrëveshje të kundërt. Në asnjë rast, pranuesi i ofertës nuk mund të ushtrojë pjesërisht të drejtën e parablerjes.
- 9.7. Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, kuotat e ofruara në njoftim mund t'i transferohen blerësit të ofruar sipas çmimit të specifikuar.

### **KAPITULLI III ASAMBLEJA, ADMINISTRATORËT DHE EKSPERTI KONTABËL**

#### **Neni 10 – Asambleja e ortakëve dhe kompetencat e saj**

- 10.1. Asambleja e Ortakëve është organi vendim-marrës i Shoqërisë.
- 10.2. Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse dhe merr vendim me unanimitet për çështjet vijuese:
  - ndryshimet e satutit,
  - zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit,
  - riorganizimi dhe prishja e shoqërisë,

*si edhe*

  - për çdo vendim tjetër parashikuar nga ky Statut, nga një Vendim Unanim i Ortakëve të shoqërisë dhe nga legjislacioni përkates.
- 10.3. Asambleja e ortakëve vendos në përputhje me legjislacionin në fuqi përsa i përket: emërimit e shkarkimit të administratorëve, ekspertëve kontabël e likuidatorëve, për politikat tregtare të shoqërisë; për mbikqyrjen e politikave tregtare të aplikuara nga administratorët, përfaqësimi në gjykatëdhe në procedime të tjera për administratorët e tjerë si dhe në lidhje me çdo vendim tjetër të parashikuar në Statut ose nga legjislacioni në fuqi.

#### **Neni 11 – E drejta e pjesëmarrjes dhe e votës**

- 11.1. Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamble, të paraqesë mendimin e tij dhe të japë aq vota sa është numri i kuotave që ai zotëron.
- 11.2. Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër jo-ortak, i pajisur me prokurë me shkrim, me anën e së cilës mund të japë votën e tij.
- 11.3. Ortaku nuk mund të lëshojë prokurë për votim vetëm për një pjesë të kapitalit që zotëron.

## Neni 12 – Thirrja e Asamblesë së Ortakëve, Kuorumi dhe Vendimet

- 12.1 Asambleja e Ortakëve thirret të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit finanziar për miratimin e bilancit, të raportit të Administratorit/ve, dhe/ose ekspertit kontabël (nëse është emëruar) si dhe të inventarit.
- 12.2 Asambleja mund të thirret në çdo moment prej Administratorit me iniciativën e tij ose sipas kërkeses që do ti drejtohet Administratorit nga një ose disa prej ortakëve që përfaqësojnë të paktën 5% (pesë) përqind të kapitalit themeltar. Asambleja thirret nëpërmjet: a) njoftimit me letër rekomande me kthim përgjigje, b) Faksit; c) Postë elektronike.
- 12.3 Lajmërimi do t'u dërgohet ortakëve jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.  
Në rast njoftimi me poste elektronike, përveç afatit 7 ditor jepet edhe një periudhe shtesë prej 5 (pesë) ditësh kalendarike. Njoftimi per seicilin ortak dergohet ne adresat respektive pershkruar ne hyrje te ketij akti.  
Thirrja duhet të përbajë informacion mbi llojin e Asamblesë, mbi rendin e ditës që do të trajtohen dhe për të cilat do të merret vendim, mbi vendin, orën dhe datën e thirrjes.
- 12.4 Në rast se Asambleja e Ortakëve nuk mblidhet me thirrjen e parë për mungesën e kuorumit, Asambleja e Ortakëve konform ligjit do të thirret me të njëjtin rend dite.
- 12.5 Mbledhjet e Asamblesë mund të mbahen edhe nëpërmjet telekonferencës dhe videokonferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe t'u lejohet atyre të ndjekin diskutimin dhe të ndërhyjnë në momentin e trajtimit të çështjeve në rend të ditës, pasi të jetë verifikuar se këto kërkesa janë përbushur dhe të rezultojnë në procesverbalin e mbledhjes.
- 12.6 Asambleja konsiderohet e mbajtur rregullisht nësë Asambleja mblidhet në selinë e shoqërisë. Asambleja konsiderohet se mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve të njoftimit e të vendmbajtjes në rast se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të tërë kapitalin themeltar.
- 12.8 Vendimet e Asamblesë së Ortakëve, për të cilat kërcohët një shumicë e kualifikuar, përjashto vendimet e parashikuara në nenin 10.2 janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar.
- 12.9 Per drejtimin e punëve në çdo Asamble zgjidhet një Kryetar, ortak ose ndonjë përson tjetër jo-ortak i caktuar nga vetë Asambleja. Për pasqyrimin e vendimit Asambleja emëron një Sekretar, që mund të jetë edhe jo-ortak.
- 12.10 Vendimet e Asamblesë duhet të nënshkruhen nga Ortakët.

### Neni 13 – Njoftimi

- 13.1. Njoftimi i ndërsjelltë ndërmjet Administratorit, Personelit drejtues dhe bashkëpunëtorëve të shoqerisë, do të realizohet nëpërmjet: a) njoftimit me letër rekomande me kthim përgjigje, b) Faksit; c) Postë elektronike; d) njoftimit në faqen zyrtare elektronike të shoqerisë;
- 13.2 Njoftimi me postë elektronike do të konsiderohet i kryer me kalimin e një afati total prej 12 (dymbëdhjetë) ditësh kalendarike nga data e nisjes se e-mailit nga njoftuesi. Ky aftat përbëhet dhe është shumatore e afatit minimal ligor prej 7 (shtatë ) ditë dhe afatit prej 5 (pesë) ditësh kalendarike të lënë në dispozicion për konsultim të emailt.
- 13.3. Njoftimi për seicilin ortak dërgohet në adresat respektive përshkruar në hyrje të këtij akti. Administratori, Personeli drejtues dhe bashkëpunëtorët e kontraktuar nga shoqëria duhet të depozitojnë adresën e tyre elektronike në shoqëri;
- 13.4. Njoftimi nëpermjet faqes zyrtare elektronike të shoqërisë konsiderohet i kryer me kalimin e prej 12 ( dymbëdhjetë) ditëve kalendarike, siç parashikohet ne nenin 13.2 , më siper.

### Neni 14 – Administrimi

- 14.1. Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Asamblese së Ortakëve.
- 14.2 Shoqëria drejtohet nga administratori i cili zgjidhet për një periudhë prej pese (5) vjet, me të drejtën për tu riemëruar nëse Asambleja nuk vendos ndryshe para mbarimit te mandatit të administratorit.
- 14.3 Administratori i Shoqërisë do të jetë:

Z. **Klodian Allka**, atësia Haki, amnesia Lutfije, i lindur më 20.04.1980, në Gur, Lushnje dhe banues në Durres me adresë Rruga Aleksander Goga, Nd. 92, H 9, Ap. 7 shtetas Shqiptar, e identifikuar nëpërmjet leternjoftimit me Nr. I00420120C, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- 15 Administratori i shoqërisë, Z. **Klodian Allka**, emërohet për një afat 5 (pesë) vjeçar nga data e nënshkrimit të këtij akti.
- 14.5. Administratori ushtron kompetencat në përputhje me nenin 95 të ligjit nr. 9901/14.04.2008 “Per tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.
- 14.6 Administratori mund të emërojë përfaqësues të posaçëm për veprime apo kategori të caktuara veprimesh.



### **Neni 15 – Eksperti kontabël i autorizuar**

- 15.1 Në rast se kërcohët nga ligji apo vendoset nga Asambleja e Ortakëve, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël të Shoqërisë mund t'i besohet një ose disa ekspertëve kontabël të autorizuar.
- 15.2 Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

## **KAPITULLI IV VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE**

### **Neni 16 - Viti finanziar dhe bilanci vjetor**

- 16.1 Viti finanziar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit.
- 16.2 Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar miratohen nga Asambleja me shumicën e kërkuar nga Ligjit n. 9901 te dates 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”.
- 16.3 Miratimi i dokumentave që lidhen me vitin finanziar duhet të bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve që nga fundi i vitit finanziar.

### **Neni 17 – Fitimet**

Fitimi i realizuar nga aktiviteti i shoqërisë i takon ortakut themelues në masën:

a) **Z. Klodian Allka 100%**

- 17.1 Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor, u shpërndahen ortakëve në proporcion me pjesët e kapitalit themeltar të zotëruara.
- 17.2 Asambleja mund të vendosë zbritje të veçanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, përvitet financiare të ardhshme.

## **KAPITULLI V SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË**

### **Neni 18 – Prishja**

- 18.1 Shoqëria mund të prishet në rastet e parashikuara nga ligji, ose me anë të një vendimi të Asamblesë së Ortakëve, me shumicën e kërkuar për ndryshimet në statut.
- 18.2 Shoqëria nuk prishet në rast të humbjes së zotësisë për të vepruar, vdekjes, ose falimentimit të ortakëve.

## Neni 19 – Likuidimi

- 19.1 Në rast prishje, Shoqëria duhet të likuidohet.
- 19.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivit dhe pasivit të Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.
- 19.3 Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja do të vodosë mbi bilancin finanziar përfundimtar, mbi punën e kryer nga likuiduesi dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.
- 19.4 Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do t'i shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit ortakëve, në proporcion me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre në kapitalin themeltar.

Për çfarë nuk është parashikuar në këtë statut do të zbatohet legjislacioni në fuqi.

Ky Akt hartohet ne 3 kopje originale, me të njëjtën vlerë ligjore, një kopje depozitohet në Qëndrën Kombëtare të Biznesit, dhe nga një kopje për seicilin ortak themeltar.

Ky akt u lexua dhe u kuptua nga nënshkruesit të cilët deklarojnë se akti është i rregullt, tëresisht dhe në çdo paragraf në përputhje me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, jadin pëlqimin për sa përmendet në akt dhe nënshkruajnë rregullisht në çdo faqe dhe emër, mbiemër dhe firmë në mylli të aktit.

### ORTAKU THEMELUES I SHOQERISË TREGTARE

Bujtina “Allka” sh.p.k  
Klodja Allka

Klodja Allka

